



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 27 maj 2014

Numri i lëndës: 2013-27

Shaban Kadriu

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 maj 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 27 dhjetor 2013.

II. FAKTET

2. Faktet e lëndës siç janë parashtruar nga ankuesi mund të përmbliidhen si në vijim.
3. Në janar 1990, ankuesi ka lidhur një kontratë pune me *“Kuvendin Komunal të Shtimes - Drejtoria e të hyrave shoqërore”*. Ankuesi ishte punësuar si nëpunës për mbledhjen e taksave tatimore.
4. Më 12 tetor 1990, *“Kuvendi komunal i Shtimes - Drejtoria e të hyrave shoqërore”* kishte ndërprerë marrëdhënia e punës së ankuesit. Arsyeja e dhënë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit ishte se *“ishte solidarizuar me grevën e përgjithshme një ditore dhe kishte munguar pa arsye nga vendi i [tij i] punës”*.
5. Në mars 2004, kjo pozitë që më herët ishte mbajtur nga ankuesi ishte shpallur si vend i liri i punës. Ai kishte konkurruar për këtë pozitë, mirëpo nuk kishte pasur sukses që të përzgjedhet.
6. Më 7 prill 2004, ankuesi ka parashtruar ankesë kundër këtij vendimi në komisionin ankimor të komunës së *Shtimes*. Në një datë të pasaktësuar ankesa ishte refuzuar si e pabazuar.
7. Më 26 dhjetor 2006, ankuesi ka parashtruar padi kundër komunës së *Shtimes* në Gjykatën Komunale në *Ferizaj*, që ishte refuzuar më 15 prill të vitit 2008 si e pabazuar.
8. Më 6 prill 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
9. Më 15 mars 2012, Gjykata Supreme e Kosovës hodhi poshtë kërkesën e ankuesit për rishqyrtimin e lëndës së tij. Sipas dokumenteve të paraqitura nga ankuesi, asnjë gjykatës i EULEX-it nuk ishte në panelin e gjykatës supreme.
10. Më 12 korrik 2012, ankuesi ka paraqitur një kërkesë për *“vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimin të gjykatës supreme”* në Gjykatën Kushtetuese. Më 15 janar 2013, Gjykata Kushtetuese, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve ndërkombëtarë, ka shpallur kërkesën e ankuesit të papranueshme. Gjykatësit ndërkombëtarë në përbërje të panelit të Gjykatës Kushtetuese nuk ishin gjyqtarë të EULEX-it.
11. Më 27 korrik 2013, ankuesi ka dërguar një letër në EULEX, duke u ankuar se komisioni përzgjedhës i komunës së *Shtimes* kishte refuzuar kërkesën e tij që të kthehej në pozitën e tij të mëparshëm. Ankuesi kishte kërkuar nga EULEX-i që t'i ndryshonte vendimet e organeve, ku e kishte parashtruar një ankesë në të kaluarën dhe që të kërkonte nga institucionet e Kosovës që t'i paguanin të gjitha pagat në mënyrë retroaktive nga viti 1999 e këtej.

12. Më 7 gusht 2013, EULEX-i ka njoftuar ankuesin se kërkesa e tij nuk bie në kuadër të mandatit të EULEX-it dhe ka sugjeruar që ai të kontaktonte ndonjë avokat privat ose ndonjë ofrues të ndihmës ligjore pa pagesë për ta këshilluar rreth mjeteve të mundshme ligjore.

III. ANKESAT

13. Në thelb, ankuesi kërkon nga Paneli që ta rikthen në pozitën e tij të mëparshëm të punës dhe që t'i paguhen të gjitha pagat e paguara nga viti 1999 e këtej.

IV. LIGJI

14. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
15. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
16. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
17. Paneli rithekson se sipas rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Si pasojë, Paneli nuk mund të ndikoj në rezultatin e procedurave gjyqësore apo shpejtësinë me të cilat ankesat në pritje shqyrtohen nga gjykatat e Kosovës. Edhe nëse e marrim se gjykatësit e EULEX-it kanë marrë pjesë në ndonjë procedurë në të cilën ankuesi ishte i përfshirë, Paneli rithekson se edhe nëse gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (në mesin e shumë vendimeve të tjera shih: *J kundër EULEX-it*, nr. 2013-04 në par. 13,

Gani Zeka kundër EULEX-it, nr. 2012-02 në par. 21; *Z kundër EULEX-it*, nr. 2012-06 në par. 31).

18. Për më tepër, Paneli ka konstatuar se nuk është treguar e as argumentuar se EULEX-i Kosovë ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në rrethanat e këtij rasti (për shembull shih: *Kahrs kundër EULEX-it*, 2012-16, 10 prill 2013 në par. 35 dhe *Hamiti kundër EULEX-it*, 2012-01, 5 qershor 2012 në par. 17). Kërkesa e ankuesit që është parashtruar në EULEX, e përmendur në par. 11 më lartë, nuk i mundësojnë Panelit të ketë kompetenca për të shqyrtuar lëndën, pasi që atëherë kur EULEX-i iu ka përgjigjur letrës së tij, nuk e ka ushtruar mandatin e tij ekzekutiv brenda kuptimit të Konceptit Llogaridhënës së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 rreth themelimit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. EULEX-i nuk ka as kompetenca për të kryer veprimet e kërkuara nga ankuesi.
19. Rrjedhimisht, kjo ankesë bie jashtë mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese